

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Edukimit, Programi Fillor
Titulli i lëndës:	Psikologjia zhvillimore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr Pranvera Jetishi Çollaku
Detajet kontaktuese:	044/621-873, pranvera.jetishi@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Programi i lëndës Psikologji Zhvillimore ofron për studentët, shpjegime teorike dhe informacion bashkëkohor rreth kuptimit të zhvillimit njerëzor dhe karakteristikave zhvillimore që manifestohen në çdo periudhë të jetës. Ky program ofron mundësinë e aftësimit të studentëve për të gjitha fushat e zhvillimit, si në aspektin fizik, mendor (kognitiv), gjuhësor, empocional, social dhe moral. Përfshirja në studim e gjithë fazave të jetës, ka për qëllim të përmbushë jo vetëm nevojat e ngushta profesionale të studentëve për të punuar me një grup-moshë të caktuar fëmijësh apo të rriturish, por edhe të kompletojnë kulturën e tyre vetjake, për të reaguuar në mënyrë të përshtatshme ndaj ndryshimeve personale ndër vite dhe për të rritur cilësinë e ndërveprimit me të tjerët, qofshin këta kolegë pune, mësues të shkollës, prindër nxënësish, të afërm, etj.</p>
Qëllimi i lëndës	<p>Lënda Psikologji zhvillimore ka për qëllim aftësimin e studentëve që të kuptojnë më mire procesin psikologjik të zhvillimit njerëzor që nga lindja dhe se si ndodhë në të gjitha fushat si në aspektin fizik, mendor (kognitiv), gjuhësor, emocional, social dhe moral.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojmë procesin e zhvillimit njerëzor dhe forcave kryesore që qëndrojnë mbrapa këtij zhvillimi (të përkufizojnë zhvillimin), • Të vlerësojnë nga këndvështrime të ndryshme teorike procesin e ndryshimeve zhvillimore që ndodhin në stadet

	<p>e jetës (ti njohin teoritë e zhvillimit njerëzor),</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë dhe shpjegojnë ndryshimet që ndodhin gjatë zhvillimit prenatal, • Të njohin faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sjelljes motorike gjatë foshnjërisë (reflekset, maturimi, dhe gatishmëria për të mësuar), • Të kuptojnë zhvillimin e personalitetit gjatë foshnjërisë, • Të kuptojnë dhe analizojnë progresin fizik, njohës dhe psiko-social që ndodh në vitet e fëmijërisë së hershme, • Të njohin zhvillimin fizik dhe pubertetin në fazën e adoleshencës, • Të njohin problemet themelore të personalitetit dhe të zhvillimit social në adoleshencë, • Të njohin zhvillimin në moshën e rritur etj.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	2	2
Totali	Vërejtje: 1 ECTS kredi= 25 orë		125

	angazhim,psh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		